

# Zyra e Koordinatorit për Aktivitetet Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së

## Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive



# Fatkeqësitë dhe siguria

Fatkeqësitë cenojnë sigurinë e njerëzve dhe kombeve. Pasojat e tyre mund të kapërcejnë kufijtë, prandaj bashkëpunimi ndër-kufitar është shpesh i nevojshëm për trajtimin e sfidave që paraqesin fatkeqësitë. Ndryshimet klimatike pritet të rrisin shpeshtësinë dhe shkallën e fatkeqësive. OSBE-ja me qasjen gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë, luan rol të rëndësishëm në forcimin e aftësisë përbaluese të komuniteteve, shteteve dhe rajoneve.

Metodat dhe mjetet e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive përmbajnë mjete të fuqishme për bashkëpunim dhe veprim të përbashkët

mes shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe aktorëve të ndryshëm, duke kontribuar në parandalimin e konflikteve dhe forcimin e besimit.



Automjetet e OSBE-së dërgohen në komunitetet e prekura për të ndihmuar autoritetet në vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në Bosnjë-Hercegovinë në maj 2014.

## Mandati

Rëndësia e bashkëpunimit për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive u njoh në **Aktin Final të Helsinkit në 1975-ën**. Kjo ngjarje u pasua nga disa dokumente politikash që i referoheshin gatishmërisë dhe menaxhimit të fatkeqësive në kontekstin e OSBE-së, përfshirë **Strategjinë e OSBE-së për Dimensionin Ekonomik dhe Mjedisor 2003 si dhe Deklaratën e Madridit për Mjedisin dhe Sigurinë 2007**.

## Vendimi i Këshillit Ministror për Forcimin e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive

miratuar në Bazel në vitin 2014, është guri i themelit i politikës së OSBE-së në këtë fushë. Vendimi e pranon që fatkeqësitë mund të jetë faktor i mundshëm shtesë për provokimin e konflikteve dhe që konfliktet rëndojnë cenueshmërinë e shoqërisë ndaj fatkeqësive. Gjithashtu, vendimi thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet shteteve pjesëmarrëse në menaxhimin e riskut të fatkeqësive.

Aktivitetet e OSBE-së në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive janë pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare për të siguruar një të ardhshme më të qëndrueshme për të gjithë.

Ato kontribuojnë në zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, ashtu si Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030, miratuar në Konferencën e tretë Botërore të OKB-së për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në vitin 2015.



# Çfarë bëjmë ne

OSBE-ja forcon kapacitetet e shteteve pjesëmarrëse në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, përmes aktiviteteve në terren që zbatohen prej Zyrës së Koordinatorit për Aktivitetet Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së (OCEEA) dhe misionet në terren të OSBE-së në bashkëpunim me partnerët e specializuar.


## Menaxhimi i zjarreve në pyje

OSBE-ja forcon kapacitetet e autoriteteve kombëtare dhe profesionistëve në menaxhimin e riskut të zjarreve në pyje, si edhe në ngritjen e kornizave të harmonizuara rajonalisht për menaxhimin e këtyre zjarreve. Në Kaukazin Jugor, OSBE-ja ka ndihmuar shtetet pjesëmarrëse në përgatitjen e politikave kombëtare për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe ka mbështetur

krijimin e Sistemit të Kategorizimit të Rrezikut të Zjarrit si një instrument paralajmërimi të hershëm. Po kështu, OSBE-ja ka mbështetur ngritjen e Qendrës Rajonale të Burimeve për Menaxhimin e Zjarrit në Mongoli, si ndihmë për përpjekjet e menaxhimit të fatkeqësive në këtë vend dhe në rajonin e Azisë Qendrore. OSBE-ja punon edhe me Bjellorusinë dhe Ukrainën për zvogëlimin e risqeve që zjarret në pyje paraqesin



OSBE-ja organizon kurse trajnimi rajonale për forcimin e kapaciteteve të autoriteteve kombëtare përkatëse dhe profesionistëve në menaxhimin e risqeve nga zjarret në pyje.



Cikli i reduktimit të riskut të fatkeqësive: Projektet dhe aktivitetet e OSBE-së përqendrohen te gatishmëria dhe bashkëpunimi.

për komunitetet, zjarrfikësit dhe mjedisin, brenda dhe përreth zonës së kontaminuar nga tragjedia bërthamore e Çernobilit në 1987-ën.

## Zvogëlimi i riskut të përmbytjeve

OSBE-ja lehtëson bashkëpunimin ndërkuftar për ujin dhe trajnon autoritetet kombëtare dhe profesionistët për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive. Seminarat dhe ushtrimet praktike mbulojnë

çështje si modelimi dhe hartëzimi i riskut të fatkeqësive në zona të cënueshme, vlerësimet e cënueshmërisë dhe komunikimi për riskun e përmbytjeve ndërmjet vendeve që shtrihen buzë lumenjve dhe popullatës së interesuar. OSBE-ja ka mbështetur masat zbutëse për fatkeqësitë në basenin lumor të Dnjesterit, të cilat përfshinin instalimin e stacioneve të monitorimit nga Ukraina dhe Moldavia dhe aktivitete për rehabilitimin e ekosistemit.



Meqë përmbytjet kanë shpesh natyrë ndërkuftare, OSBE-ja lehtëson aktivitetet rajonale që ndihmojnë shtetet të krijojnë mekanizmi të fortë koordinimi. Në 2016-ën, OSBE-ja mbledhi përfaqësues nga Kirgizistani dhe Tashkikistani për një kurs trajnimi mbi zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.

# Çfarë bëjmë ne (vazhdon)

## Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive në nivel komuniteti

OSBE-ja forcon bashkëpunimin ndërkuftar mes komuniteteve dhe bashkive me risk të lartë, me anë të organizimit të trajnimeve të përbashkëta dhe dhënies së asistencës teknike për hartimin e planeve vendore për reduktimin e riskut të fatkeqësive. Në këtë kontekst, OSBE-ja mbështetet te Qendrat Aarhus që ofrojnë platforma



për institucionet vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat që të trajtojnë bashkërisht sfidat e mjedisit dhe sigurisë në nivel vendor. Qendrat Aarhus janë trajnuar dhe mbështetur në nxitjen e reduktimit të riskut të fatkeqësive në nivel komuniteti, si edhe në sensibilizimin për rritjen e masave që forcojnë gatishmërinë ndaj fatkeqësive.



OSBE-ja forcon kapacitetet e Qendrave Aarhus në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, pasi ato luajnë rol të rëndësishëm në sensibilizimin në nivel komuniteti dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut në proceset e planifikimit vendor.

## Sigurimi i mjeteve dhe orientimeve

OSBE-ja përgatit botime për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, që t'iu shërbejnë profesionistëve si materiale referencë në kuadrin e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve dhe sensibilizimit për komunitetet e rrezikuara.



### Follow OSCE



Sekretariati i OSBE-së  
**Zyra e Koordinatorit për Aktivitetet  
Ekonomike dhe Mjedisore**

Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vienna, Austria

pm-eea@osce.org  
www.osce.org/sekretariat/eea  
www.osce.org/sekretariat/disaster-risk-  
reduction-and-security